



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 640 , datë 7.9.2016

P Ë R

**KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT TË FONDIT
TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr.13/2016, "Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në bashkitë Kavajë e Fier.
2. Për një periudhë kohe deri në konsolidimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve, ky shërbim do të ofrohet, njëkohësisht, nga ADISA dhe FSDKSH-ja.

3. Ngarkohen Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

MILENA HARITO



NR.PROT.4369/4
DATË 8.9. 2016

MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)
FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR (FSDKSH)
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

